




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

DATE/A:	13.07.2026
PËR:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
NGA:	Agron Hoxha, Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm
TEMA/ LËNDA:	RAPORTI I MONITORIMIT TE PROGRESIT TE ZBATIMIT TË REKOMADIMEVE TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR KOMUNËN E PRIZRENIT PËR PERIUDHEN JANAR-QERSHOR 2026





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit-
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Njësia e Auditimit të Brendshëm

RAPORT I AUDITIMIT
PËR PËRCJELLJEN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA
NJESIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË AUDITIMET E
REALIZUARA NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Prizren, korrik 2026

RAPORT I AUDITIMIT PËR PËRCJELLJEN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA NJESIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË AUDITIMET E REALIZUARA NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Ne kemi kryer auditimin periodik në Komunën e Prizrenit, lidhur me adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm për periudhën Janar-qershor 2026 si dhe rekomandimet e bartura(ta pa zbatuara) nga viti 2025. Ne kemi rishikuar të zbatimin e rekomandimeve duke u bazuar në afatet kohore të dhëna në Planet e veprimit nga menaxhmenti i njësive të Audituar. Ne kemi konstatuar se Menaxhmenti për disa rekomandime ka ndërmarrë veprime për zbatimin e tyre, ndërsa për rekomandimet tjera mbetet që në periudhën e dytë të vitit 2026 të vlerësohet zbatimi i tyre. Pjesë e këtij rishikimi ishin edhe rekomandimet e bartura të pa zbatuara ose pjesërisht të zbatuara të vitit 2025, për të cilat pas rishikimit në janar 2026, janë dhënë afate për zbatimin e tyre deri në fund të vitit 2026. Është përgjegjësi e menaxhmentit të njësive të audituara të sigurojnë zbatimin e rekomandimeve sipas afateve të dhëna në planet e tyre të veprimit.

Gjendja:

Gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë verifikuar 19 rekomandime (8 të vitit 2026 dhe 11 të vitit 2025, të cilat kanë qenë rekomandime të bartura për rishikim).

- Nga to:
 - 7 rekomandime apo (37%) janë zbatuar plotësisht(2 rekomandime të auditimeve të realizuara për periudhën e parë të vitit 2026, dhe 5 rekomandime të auditimeve të bartura për rishikim nga viti 2025);
 - 9 rekomandime apo (47%) janë në proces zbatimi(6 rekomandime të auditimeve të realizuara për periudhën e parë të vitit 2026, dhe 3 rekomandime të auditimeve të bartura për rishikim nga viti 2025);
 - 3 rekomandime apo (16%) janë të pazbatuara(3 rekomandime të auditimeve të bartura për rishikim nga viti 2025).

Më poshtë kemi paraqitur në forma tabelare rekomandimet e dhëna, afati për zbatimin e tyre, veprimet që janë ndërmarrë, përgjegjësit dhe statusi zbatimit/mos-zbatimit dhe rekomandimeve që janë në proces të zbatimit(tabela 1 dhe 2).

TABELA 1: ECURIA E ZBATIMIT TE REKOMANDIMEVE PER AUDITIMET E REALIZAUARA PER PERIUDHEN JANAR-QERSHOR 2026

REKOMANDIMET	Data e raportit (përfundimi)	AFATI I IMPLEMENTIMIT	PËRGJEGJËSIT	VEPRIMET QË JANË NDËRMARRË	PROGRESI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE				
					I ZBATUAR	PJESËRISHT I ZBATUAR		I PAZBATUAR	NUK APLIKOHET
						Faza fillestare e zbatimit	Zbatimi në process		
Emërtimi i auditimit: Auditimi i Performancës: Subvencionimi me mekanizëm Bujqësor 2024-2025 Rekomandimi 1: Përcaktimi i nevojave për mekanizëm bujqësor të bëhet në mënyrë të strukturuar, përmes organizimit të takimeve publike me fermerët e komunës, me qëllim të identifikimit të nevojave reale për llojet e mekanizmit. Njëkohësisht, drejtorja duhet të zhvillojë mekanizma të përshtatshëm për matjen e efekteve të subvencionimit, në mënyrë që rezultatet e arritura të shërbejnë si bazë për përmirësimin e politikave të mbështetjes në të ardhmen.	07.04.2026	Dhjetor 2026	DBZHR	Komunikimi me fermer, strategjia e komunës ku janë përcaktuar prioritetet	☐	☐	√	☐	☐
Rekomandimi 2: Respektimi i procedurave dhe kriterëve të përfitimit duhet të sigurohet në mënyrë të plotë dhe konsistente, duke garantuar që përfitues të jenë vetëm ata fermerë që i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe që kanë nevojë reale për mekanizmin për të cilin aplikojnë.		Dhjetor 2026	Anëtarët e komisionit të vlerësimit	Janë ndërmarr veprimet e duhura	√	☐	☐	☐	☐

Rekomandimi 3: Forcimi i monitorimit të përfituesve duhet të jetë prioritet, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm dhe jo të kufizuar vetëm në një përqindje të vogël të rasteve. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh mungesën e stafit, rekomandohet që drejtoria të shqyrtojë mundësinë e angazhimit të personelit shtesë (nëpërmjet procedurave ligjore të rekrutimit apo angazhimit) të cilët do të fokusohen ekskluzivisht në monitorimin e përfituesve të subvencioneve. Kjo do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e kontrollit dhe në përdorimin e duhur të mekanizmit bujqësor nga përfituesit.		Dhjetor 2026	DBZHR	Ne kohën e monitorimit ende procedurat e subvencionimit janë në vasën e aplikimit dhe disa të vlerësimit	☐	√	☐	☐	☐
---	--	--------------	-------	--	--------------------------	---	--------------------------	--------------------------	--------------------------

REKOMANDIMET	Data e raportit (përfundimi)	AFATI I IMPLEMENTIMIT	PËRGJEGJËSIT	VEPRIMET QË JANË NDËRMARRË	PROGRESI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE				
					I ZBATUAR	PJESËRISHT I ZBATUAR		I PAZBATUAR	NUK APLIKOHET
						Faza fillestare e zbatimit	Zbatimi në process		
Emërtimi i auditimit: Auditimi i obligimeve të papaguara për periudhën janar-mars 2026 dhe viti 2025									
Rekomandimi 1: Zyrtari Kryesor Financiar rekomandohet që të forcojë kontrollet gjatë procesit të evidentimit dhe raportimit të obligimeve të papaguara, me qëllim që raportimi të jetë i plotë, i saktë dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit financiar në fuqi.	02.06.2026	15.07.2026	ZKF	Në raportet mujore evidentohen operatorët ekonomikë (furnitorët) përkatës dhe të gjitha faturat e pranuar të përfshihen në raportet e obligimeve të papaguara. Gjithashtu, para dorëzimit të raporteve të zbatohet një kontroll përfundimtar nga Zyra e Financave për të verifikuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave.	√	☐	☐	☐	☐

Rekomandimi 2: Drejtoritë komunale duhet të forcojnë procesin e evidentimit dhe raportimit të obligimeve të papaguara, si dhe të sigurojnë komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me Zyrarin Kryesor Financiar dhe të krijojnë një sistem që do të ndihmonte në mënyrë efektive ti evidentonte të gjitha detyrimet e papaguara dhe më pas ato të prezantoheshin drejtë dhe saktë në PFV-të e Komunës.		10 janar 2027	ZKF dhe Drejtoritë Komunale	Do të bëhet koordinimi ndërmjet drejtorive komunale dhe Zyrarit Kryesor Financiar për raportimin në kohë të të gjitha obligimeve të papaguara. Të hartohet një procedurë e brendshme (ose listë kontrolli) për evidentimin, verifikimin dhe raportimin e faturave të pranuar para përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore, në mënyrë që të gjitha detyrimet të prezantohen në mënyrë të plotë dhe të saktë.	☐	√	☐	☐	☐
---	--	---------------	------------------------------------	---	--------------------------	---	--------------------------	--------------------------	--------------------------

REKOMANDIMET	Data e raportit (përfundimi)	AFATI I IMPLEMENTIMIT	PËRGJEGJËSIT	VEPRIMET QË JANË NDËRMARRË	PROGRESI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE				
					I ZBATUAR	PJESËRISHT I ZBATUAR		I PAZBATUAR	NUK APLIKOHET
						Faza fillestare e zbatimit	Zbatimi në process		
Emërtimi i auditimit: Rregullsitë e procesit të planifikimit dhe arkëtimit të të hyrave nga Tatimi në Pronë dhe Tokë									
Rekomandimi 1: Menaxhmenti i drejtorisë së tatimit në pronë, duhet që të bëjë planifikim të saktë të të hyrave nga tatimi në pronë në përputhje me dokumentet zyrtare financiare siç është plani afatmesëm i të hyrave i cili është pjesë përbërëse e ligjit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe të bashkëpunojnë	30.06.2026	Gjatë vitit 2026	DTP, Udhëheqësi i ZTP	Për periudhën raportuese 3 rekomandimet e deklaruar në proces , janë rekomandimet e auditimit të fundit të periudhës raportuese, afati për zbatimin e tyre në PV nga drejtorit përkatëse, përfshinë përdhën e dytë të vitit 2026.	☐	√	☐	☐	☐

me zyrën e financave lidhur me planifikimet buxhetore.									
Rekomandimi 2: Drejtoria e tatimit në pronë duhet që të rrisin kontrollin e brendshëm dhe të respektohen kërkesat ligjore lidhur me arkëtimin e të hyrave nga tatimi në pronë veçanërisht nga ata tatimpagues që kanë obligime të larta të papaguara. Po ashtu duhet shqyrtuar mundësia angazhimit të punonjësve shtesë apo kontraktimeve të jashtme njëjtë siç është vepruar me inspektimin e pronave e cila do të ndikonte në zvogëlimin e llogarisë së arkëtueshme nga tatimi në pronë		Është proces i vazhdueshëm nuk mundet të zbatohet brenda vitit 2026	DTP, Udhëheqësi i ZTP		☐	√	☐	☐	☐
Rekomandimi 3: Drejtoria e tatimit në pronë, duhet që ti përmbahet afateve kohore në shqyrtimin e ankesave të tatimpagueseve, ti zgjidhë brenda afateve kohore të parapara. Kjo do të rrisë performancën dhe efektivitetin e drejtorisë.		Gjatë vitit 2026	Zyrtaret e terrenit te TP dhe Menaxhmenti i TP		☐	√	☐	☐	☐

Total statusi i rekomandimeve (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar/në proces ose i pa zbatuar) për të gjitha rekomandimet për periudhën janar- qershor 2026

Total	Gjithsej:8 Të zbatuara:2 Pjesërisht/proces: 6 Të pazbatuara: 0
--------------	---

TABELA 2: ECURIA E ZBATIMIT TE REKOMANDIMEVE TË AUDITIMIT NGA VITI PARAPRAK

EMRI I AUDITIMIT	DATA E DERGIMIT TE RAPORTIT	REKOMANDIMET	AFATI I RISHIKUAR PER ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE	VEPRIMET QË JANË NDËRMARRË	STATUTI I REKOMANDIMEVE NE FUND TE VITIT (AFATI =1+2)
Auditimi i Performancës për menaxhimin dhe ruajtjen e pasurisë jo financiare në Administratën Komunale, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Arsimit për vitet 2023/2024	16.07.2025	Rekomandimi 1: Menaxhmenti duhet të kujdeset që të rrisë efektivitetin në raport me regjistrimin e pasurisë jo financiare kapitale në SIMFK	30.06.2026	Janë ndërmarr veprimet e duhura	I ZBATUAR
		Rekomandimi 2: Zyrtari i pasurisë i cili është përgjegjës për të mirëmbajtur regjistrat e pasurisë jo financiare kapitale, të mbajë në mënyrë kronologjike të gjitha pagesat të cilat lidhen me një projekt të caktuar dhe ti mbyllë me kohë ato investime të cilat kanë përfunduar	30.06.2026	E gjetura/rekomandimi lidhur me mos mbylljen e investimeve në vijim nuk mund të zbatohet në tërësi brenda vitit 2026, pasi procesi do të vazhdojë deri në përmbylljen e të gjitha investimeve të pambyllura që nga viti 2013.	I PA ZBATUAR
		Rekomandimi 5: Për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë jo financiarë sidomos të drejtorisë së arsimit, duhet që të tentohet të funksionalizohet rrjeti i cili e bën të mundur funksionimin e sistemit e-pasuria në të gjitha shkollat e komunës së Prizrenit	30.06.2026	Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatueshëm. Gjate vitit 2025 dhe rishikimit ne këtë periudhe , regjistrimi i pagesave te realizuar nga shkollat ka vazhduar nga zyrtari i caktuar I DKA, por jo secila njësi(shkolle) e cila ka buxhet bënë regjistrimin në sistemin e-pasuria në mungese te funksionalizimit të plotë të sistemit.	PJESËRISHT I ZBATUAR
Menaxhimi i shpenzimeve për Mallra & Shërbime dhe shpenzime komunale		Rekomandimi 2: Zyrtarët përgjegjës duhet të sigurojnë që të gjitha faturat e pranua të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor, Kjo do të ndihmonte në shmangien e shpenzimeve shtesë që mund të lindin si rezultat i procedurave përmbartimore. •Përgjegjësit duhet të angazhohen për të siguruar raportime të sakta, të plota dhe gjithëpërfshirëse, të obligimeve financiare e jo vetëm për periudha të caktuara kohore dhe ti raportojnë te ZKF, i cili pastaj duhet te siguroj qe këto raporte te dërgohen ne Thesar. Kjo qasje do të ndihmonte në krijimin dhe mirëmbajtjen e një regjistri të besueshëm të obligimeve të paraqitura në nivel komunal.	30.06.2026	Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatueshëm. Për kundër veprimeve të ndërmarra kemi shumë fatura që kalojnë pagesa e aftit mbi 30 ditë për pagese, si dhe në disa raste kemi pasur mos raportim te plote të obligimeve financiare sipas periudhave në thesar.	PJESËRISHT I ZBATUAR

		Rekomandimi 3: Zyrtarët përgjegjës për planifikimin buxhetor duhet të sigurojnë që shpenzimet të planifikohen në përputhje me kodet përkatëse ekonomike. Është e domosdoshme të shmangen sa më shumë keq klasifikimet buxhetore, pasi ato ndikojnë në saktësinë e pasqyrave financiare dhe në raportimin korrekt të shpenzimeve të komunës. •Menaxheri i kontratës (apo projektit) duhet të tregojë kujdes të shtuar gjatë implementimit të kontratave, duke respektuar në tërësi të gjitha kushtet, procedurat dhe dispozitat ligjore të përcaktuara në kontratë, si dhe rregulloret përkatëse që rregullojnë zbatimin e tyre	30.06.2026	Ne kemi konstatuar se keq klasifikimet e buxhetuara nga komuna ne mase te madhe janë përmirësuar, megjithatë mbetet një barrë e madhe që pagesat e realizuara nga thesari për proceset përmbartimore dhe gjyqësore, end po ndikojnë në masë të madhe në keq klasifikim e pagesave	I PA ZBATUAR
Pajtueshmëri në proceset e prokurimit për kontratat me vlerë të vogël, të mesme dhe të mëdha	14.11.2025	Rekomandimi 1: Zyrtari përgjegjës i prokurimit duhet të rrisë bashkëpunimin me zyrtarët financiar lidhur me atë që planifikimi i prokurimeve të mbështetet plotësisht sipas planifikimeve buxhetore në mënyrë që të sigurohet që ka fonde të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve për këto projekte për vitet vijuese	30.06.2026	Procedurat e zhvilluara të prokurimit për vitin 2026, zhvillohen komfor procedurës se zotimit te mjeteve sipas vlerave te planifikuara ne buxhet për shkak te kërkesës së zotimeve shumë vjeçare të cilat duhet të sigurohen paraprakisht sipas lidhjes së sistemeve SIMFK dhe E-prokurimi	I ZBATUAR
		Rekomandimi.4: Zyrtari përgjegjës i prokurimit në bashkëpunim me njësitë e kërkesës dhe zyrtarët financiar duhet të siguroj që asnjë kontratë publike të mos nënshkruhet pa u zotuar fondet e ndara në buxhetin e vitit përkatës me theks të veçantë për kontratat të cilat planin dinamik të përfundimit e kanë brenda vitit fiskal.	30.06.2026	Kontraktimi i kontratave tjera të lidhura gjate vitit 2026 është duke u bazuar në harmoni me LMFPF dhe ligjin e buxhetit duke ngrit zotimet/obligimet shumëvjeçare të ndërlidhura mes sistemit SIMFK dhe e-prokurimit.	I ZBATUAR PËR KONTRATAT E VITIT 2026

Auditimi i shpenzimeve në kategorinë e investimeve kapitale në administratën e përgjithshme të komunës (duke përfshirë të gjitha drejtoritë e komunës)	30.12.2025	Rekomandimi 1: Menaxherët e kontratave duhet të sigurojnë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë në mënyrë që të shmangin vonesat e panevojshme. Po ashtu duhet që në secilën kontratë të përcaktohet qartë data e fillimit dhe data e përfundimit. Menaxherët e kontratave duhet që brenda 30 ditëve të kthejnë përgjigje operatorit nëse do të bëjnë pranimin e përkohshëm të punimeve.	30.06.2026	Nuk është adresuar plotësisht pasi që kemi konstatuar së ende ka shumë kontrata të cilat nuk respektohen afatet e dhëna në zbatimin e kontratës.	I PA ZBATUAR
		Rekomandimi2: Udhëheqësit e drejtorive, ZKF dhe zyrtarët tjerë përgjegjës duhet që para çdo obligimi të zotohen fillimisht se ka mjete të mjaftueshme financiare dhe të mos lejojnë që të ketë tejkalime të afateve ligjore për pagesën e faturave që më pas do të rezultonte me pagesë përmbartimore e cila do i rriste shpenzimet e pa planifikuara	30.06.2026	Nuk është adresuar plotësisht përkundër se eksiton një kontroll së asnjë pagese të mos kryet pa zotim të plotë të mjeteve, pagesat e obligimeve të viteve paraprake i kanë ndikuar që përmes procedurave përmbartimore të çrregullohet ritmi i pagesave të cilat pastaj, kanë ndikuar që edhe faturat e dorëzuar me kohe dhe me mjete të zotuar mos të ekzekutohen me kohe për shkak që përmbartimi ka bërë ekzekutime të dhunshme dhe janë marrë mjete financiare edhe të kontratave me mjete të zotuar	PJESËRISHT I ZBATUAR
		Rekomandimi 3: Menaxherët e kontratave duhet ti përmbahen në tërësi rregullave ligjore gjatë emërimit të tyre në cilësinë e menaxherit të kontratës. Ata duhet ti përgatisin planin e menaxhimit të kontratave në mënyrë të saktë ashtu siç kërkohet, në mënyrë që procesi i menaxhimit të kontratës të jetë më efektiv dhe transparent.	30.06.2026	Janë ndërmarr veprimet e duhura	I ZBATUAR
		Rekomandimi 4: Menaxherët e kontratave duhet që ti obligojnë kontraktuesit (kryesit e punimeve) që ti plotësojnë në tërësi kushtet e kontratës që kanë të bëjnë me garancitë bankare për sigurimin e cilësisë së punimeve	30.06.2026	Janë ndërmarr veprimet e duhura	I ZBATUAR

Total	Gjithsej:11 Të zbatuara: 5 Pjesërisht/proces: 3 Të pazbatuar: 3
-------	--

Konkluzion i përgjithshëm

Bazuar në rishikimin e kryer për periudhën janar–qershor 2026, konstatohet se menaxhmenti i njësive të audituara ka ndërmarrë veprime konkrete për adresimin e një pjese të rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm. Rezultatet tregojnë një progres në zbatimin e rekomandimeve, duke marrë parasysh se 37% e tyre janë zbatuar plotësisht, ndërsa 47% janë në proces të zbatimit, çka tregon angazhim të menaxhmentit për përmirësimin e kontrolleve të brendshme dhe adresimin e mangësive të identifikuara.

Megjithatë, mbetet e nevojshme që të vazhdohet me një qasje më dinamike në zbatimin e rekomandimeve, veçanërisht për ato të bartura nga viti 2025, pasi ende 16% e tyre rezultojnë të pazbatuara. Duke qenë se shumica e rekomandimeve në proces kanë afate përfundimtare deri në fund të vitit 2026, vlerësimi përfundimtar i efektivitetit të zbatimit të tyre do të bëhet gjatë rishikimit të dytë të planifikuar për këtë vit.

Rekomandim

I rekomandohet menaxhmentit të njësive të audituara që të intensifikojë veprimet për zbatimin e rekomandimeve të mbetura në proces dhe atyre të pazbatuara, duke siguruar monitorim të rregullt të planit të veprimit, përcaktim të qartë të përgjegjësive dhe respektim të afateve të parapara. Gjithashtu, kërkohet që të ndërmerren masa konkrete për eliminimin e pengesave që kanë ndikuar në moszbatimin e rekomandimeve të bartura nga viti 2025, me qëllim që deri në fund të vitit 2026 të arrihet zbatimi i plotë i tyre dhe të forcohet sistemi i kontrollit të brendshëm në Komunën e Prizrenit.

Korrik 2026,
Prizren

Udhëheqësi i Auditimit të Brendshëm

Agron Hoxha

